Data e publikimit: 2 dhjetor 2016

Referenca: Kërkesa për aplikime # CEP-PG-01

Titulli: Sqarim për kërkesën për aplikime # CEP-PG-01

Pyetja 1: A ka mundësi një organizatë e huaj që ka të regjistruar filiale të saj në Maqedoni, të jetë organizatë udhëheqëse/koordinuese për rrjetin e paregjistruar të OSHQ-ve?

Përgjigja 1: Projekti për pjesëmarrje qytetare i USAID-it (PPQ) dhe kërkesa për aplikime e PPQ-së për Grante të partneritetit i targetojnë rrjetet e OSHQ-ve dhe OSHQ-të nga Maqedonia, të dytat si trup koordinues për rrjetet e paregjistruara të OSHQ-ve. Një organizatë konsiderohet se është OSHQ nga Maqedonia në qoftë se shumicën e anëtarëve të organit drejtues e përbëjnë shtetas të Maqedonisë ose banorë të përhershëm të Maqedonisë me status të rregulluar ligjor.

Pyetja 2: A mund të sqaroni se a do të kenë të drejtë OSHQ-të që aplikojnë në emër të një rrjeti të paregjistruar të OSHQ-ve dhe që do ta udhëheqin grantin në qoftë se ai u miratohet, të aplikojnë edhe për skema të tjera të granteve në kuadër të Projektit për pjesëmarrje qytetare të USAID-it?

Përgjigja 2: Të gjithë anëtarët e një rrjeti të OSHQ-ve që do fitojnë Grant të partneritetit do të kenë të drejtë të aplikojnë edhe për programe të tjera të granteve në kuadër të PPQ-së.

Pyetja 3: Si anëtarë të rrjetit momentalisht kemi tre OSHQ nga Maqedonia. A mund të inkuadrojmë edhe OSHQ të tjera nga Maqedonia në Memorandumin për mirëkuptim, siç është shënuar në kërkesën tuaj për aplikime?

Përgjigja 3: Projekti do t'u japë prioritet rrjeteve të OSHQ-ve që kanë pesë ose më tepër anëtarë që janë dëshmuar në aksione të përbashkëta së paku gjatë tre viteve të fundit. Pasi që rrjeti juaj ka tre OSHQ nga Maqedonia, ju mund të inkuadroni edhe OSHQ të tjera në Memorandumin për mirëkuptim, i cili e dëshmon përkushtimin e anëtarëve të rrjetit të OSHQ-ve që të punojnë së bashku. Mirëpo, ju lutem kini parasysh faktin se anëtarët duhet të kenë punuar në aksione të përbashkëta në tre vitet e fundit, edhe pse PPQ-ja mund të bëjë përjashtim të rrallë në qoftë se ofrohen dëshmi të mjaftueshme që do të tregojnë se udhëheqësia e rrjetit të OSHQ-ve ka përvojë paraprake adekuate dhe se rrjeti i OSHQ-ve është i aftë ta ofrojë atë që nuk është merituar në të kaluarën.

Pyetja 4: A mund të inkuadrojmë në implementim partnerë, si për shembull Odën a avokatëve?

Përgjigja 4: Po, mund të inkuadroni edhe partnerë të tjerë në rrjetin tuaj të OSHQ-ve. Këta partnerë do të kenë mundësi të pranojnë mjete nëpërmjet Granteve të partneritetit vetëm në qoftë se janë të regjistruara si organizata jofitimprurësve në Maqedoni dhe në qoftë se konsiderohen si organizata nga Maqedonia (shihni pyetjen 1 në lidhje me kriterin e dytë).

Pyetja 5: A mund të inkuadrojmë në implementimin e aktiviteteve edhe përfaqësues të OSHQ-ve nga rajoni, të cilat janë anëtare të rrjetit tonë?

Përgjigja 5: Po, OSHQ-të që i kanë selitë e tyre në rajon konsiderohen anëtarë të rregullt të rrjeteve të OSHQ-ve që kanë të drejtë të aplikojnë për Grante të partneritetit.

Pyetja 6: A mund të aplikojmë vetëm me aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve siç thuhet në faqen 01 të kërkesës për aplikime apo duhet të përfshijmë aktivitete të tjera si për shembull përfaqësimi (avokatësia), monitoringu etj.?

Përgjigja 6: Grantet e partneritetit kanë për qëllim t'i mbështesin aktivitetet a grantistëve për zhvillimin e kapaciteteve për ta përmirësuar aftësinë e tyre për të ofruar rezultate më të mira në aktivitetet që kanë të bëjnë me përfaqësimin dhe monitoringun, të cilat janë të fokusuara në çështjet me prioritet që janë me interes për qytetarët e Maqedonisë, duke e përfshirë: qeverisjen e mirë, përmirësimin e shërbimeve publike, sundimin e të drejtës, antikorrupsionin, të drejtat e njeriut, rritjen ekonomike, mjedisin që mundëson zhvillim të biznesit, si dhe monitoringun dhe mbikëqyrjen e institucioneve publike.

Pyetja 7: A duhet aktivitetet të implementohen vetëm në Maqedoni?

Përgjigja 7: Pothuajse të gjitha aktivitetet e propozuara duhet të zhvillohen në Maqedoni, përveç për pjesëmarrje (të kufizuar) në aktivitete për rrjetëzim ose përfaqësim që janë të lidhura ngushtë me intervenimet e propozuara strategjike të rrjetit të OSHQ-ve, të cilat mund të zhvillohen jashtë vendit. Sidoqoftë, nëse rrjeti i OSHQ-ve propozon aktivitete që do të zhvillohen jashtë vendit, atëherë duhet të tregohet në mënyrë të qartë rëndësia e këtyre aktiviteteve në lidhje me intervenimet e propozuara.